



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

#### PROCESVERBAL

Tiranë, më 06.02.2019, ora 10:30

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Shqyrtimi në parim i projektvendimit “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”. *(Komision përgjegjës)*

#### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Enkelejd Alibeaj, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Nasip Naço, Silva Caka dhe Elena Xhina.

#### **Mungojnë:**

Damian Gjikhuri, Fatmir Mediu, Astrit Veliaj dhe Tom Doshi

## HAPET MBLEDHJA

**Ulsi Manja** - Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. Sot në rendin e ditës kemi shqyrtimin në parim të projektvendimit “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Komisioni ynë është komision përgjegjës dhe relatore e këtij projektvendimi është kolegia Vasilika Hysi.

Në mbledhjen e javës së kaluar ne hapëm diskutimin në parim në lidhje me këtë projektvendim dhe sot kemi vazhdimin e diskutimit dhe miratimin në parim të këtij projektvendimi. Kështu që, pa humbur kohë, kush e do fjalën për diskutimin në parim?

Urdhëroni, zonja Hysi!

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Unë i kërkoja Shërbimit të Kërkimit Parlamentar dhe Bibliotekës në Kuvendin e Shqipërisë të bënte një kërkim lidhur me disa çështje që kanë interes në diskutimin e Rregullores së Kuvendit, konkretisht për tri çështje.

Së pari, modelet dhe praktikat e parlamenteve të tjera lidhur me masat disiplinore që jepen ndaj deputetëve, në përgjithësi, për shkelje të Kodit të Etikës dhe në rastet, meqenëse kemi dispozitë, e ngacmimeve seksuale.

Së dyti, mekanizmi i ankimimit ndaj masave disiplinore ka qenë një diskutim dhe debat në grupin e punës, prandaj kërkoja informacion lidhur me mekanizmin e ankimimit të masës disiplinore që mund të jepet ndaj deputetëve.

Çështja e tretë, ishte një çështje që e kërkonte stafi i Kuvendit lidhur me zbardhjet e mbledhjeve të komisioneve parlamentare, që në jo pak raste kanë qenë pjesë e debateve edhe tek ne, pra nëse në mbledhjet e komisioneve do t’i kemi vetëm me regjistrimin audio dhe video të të gjithë diskutimeve dhe krahas tij edhe një përmbledhje të diskutimit.

Shërbimi e Kërkimit kanë sjellë një material dhe kanë bërë një studim të praktikës së Parlamentit European, të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, të Bundestagut gjerman, të senatit të Republikës së Italisë, të asamblesë së Sllovenisë, Bullgarisë, Sllovakisë dhe Malit të Zi, si vende të rajonit.

Gjithashtu për këtë material, ata janë ndihmuar edhe nga Qendra Europiane e Kërkimit Parlamentar dhe Dokumentacionit. Materiali është edhe i printuar, edhe në formatin *online*,

nëse kolegët e komisionit dëshirojnë ta kenë një kopje, sekretaria t’jua vërë në dispozicion! Studimi është interesant, pak a shumë është në të njëjtat linja, kjo tregon se edhe produkti që ne kemi si dokument pune është në të njëjtën linjë me praktikën e vendeve të tjera.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Hysi!

Kush e do fjalën për diskutim?

Urdhëroni, zoti Alibeaj!

**Enkelejd Alibeaj** – Në mbledhjen e kaluar unë bëra dy kërkesa, të cilat deri tani nuk kanë marrë përgjigje. Ju pa u konsultuar me Rregulloren, sepse ka një kërkesë në është e Rregullore që nuk mund të deformohet, aq më tepër që krijon edhe një lloj paradoksi, pra ju kërkoni të bëni ndryshime në Rregullore kur vetë nuk e zbatoni Rregulloren. Kërkesa është imperative, është e Rregullores, nuk është as kërkesë imja dhe as kërkesë për t’u bërë pengesë. Jo

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Çdo tentativë për të ndryshuar Rregulloren e këtij Kuvendi duhet të kalojë, në çdo rast, në organin e posaçëm që përcakton Rregullorja, që është Këshilli për Rregulloren dhe Mandatet. Kjo është një çështje, për të është kohë e humbur të diskutojmë. Është në respektin e Rregullores dhe, mbi të gjitha, është edhe respekt ndaj traditës, siç jua thashë herën e kaluar.

Së dyti, zonja Hysi sapo tha se ka vendosur ca dokumente, të cilat nuk i janë bërë të ditura asnjërit prej kolegëve. Po të duam ne, zonja Hysi na i garanton nëpërmjet sekretarisë.

Së treti, qëndrojnë ende e shkruar e zeza mbi të bardhë, pavarësisht përgjërimeve të kolegut tuaj në seancën e kaluar, ndryshimet e kërkuara prej jush, prej kryetarit të grupit parlamentar të maxhorancës, ato për ndryshimin e imunitetit...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Vasilika, ti mund t’i kesh hequr. Si mund t’i kesh hequr?!

**Vasilika Hysi** – Do të vijmë nën për nën dhe do t’i diskutojmë.

**Enkelejd Alibeaj** - Domethënë, deri sot janë ende në tryezë. Atëherë, çfarë diskutimi në parim kërkoni ju në këtë rast?! Kur të vijë, do t’i heqim! E parashikova që në seancën e kaluar atë që po ndodh. Domethënë, ky komision nuk e ka kompetencën për të trajtuar çfarëdolloj tentative për të ndryshuar Rregulloren. Ju po e kaloni në Komisionin e Ligjeve për një arsye fare të thjeshtë, sepse sapo e thatë Vasilika: “Kur të vijë nën për nën do ta heqim”, mund edhe të mos e hiqni. Ndërkohë, jo më kot Rregullorja ka përcaktuar, bazuar edhe në traditë, që Këshilli për Rregulloren dhe Mandatet, i cili ka barazi forcash mes maxhorancës dhe opozitës, na kërkon neve, parlamentit, të injektojë pikërisht rënien dakord. Domethënë, asnjë

nga maxhoranca, që kërkon të fusë imunitetin, nuk ka të drejtë dhe nuk ka mundësi ta bëjë këtë gjë. Ja pse kërkojmë ne ta fusim në hullinë e Rregullores. Përdorni forcën e kartonit, mund ta përdorni, përdorni padijeninë e Kryetarit të Kuvendit, i cili kishte detyrim në Konferencën e Kryetarëve, sepse është Kryetar, për ta përcaktuar se kjo nuk shkon në Komisionin e Ligjeve, por në Këshillin e Mandateve. Pastaj kjo është të mos e respektosh Rregulloren. Çfarë kërkonti ju?! Të ndryshojmë Rregulloren, kur ju vetë nuk e respektoni Rregulloren. Kjo është këmba e mbrapsht me të cilën fillohet kjo lloj veprimtarie. Plotësoni këtë kërkesë, ashtu siç e do Rregullorja, hiqni dorë në mënyrë të shkruar. Taulant Balla, të shkuara i ka sjellë propozimet për imunitetin. Përgjërimit me fjalë, nuk i shkojnë askujt. Fjalët i merr era, karta është ajo që ngelet. Kjo është ftesë, bëni si të doni, nëse vërtet keni dëshirë për të përmirësuar Rregulloren, për të përmirësuar veprimtarinë e këtij parlamenti. Ne jemi të interesuar për të përmirësuar veprimtarinë e këtij parlamenti. Na hiqni fjalën, nuk na jepni të drejtat në këtë komision. Dje Nasipit ia keni hequr fjalën.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kështu që, nëse ka një gjë për të cilën juve po përgjërohemi, është të rregullojmë veprimtarinë e parlamentit. Ky parlament ka rënë me kohë e me vaktë.

**Ulsi Manja** – Të lutem, mos e lini Nasipin vetëm herës tjetër!

**Enkelejd Alibeaj** – Ky parlament është i palegjitimuar...

**Ulsi Manja** – Të lutem, zoti Shameti!

**Enkelejd Alibeaj** – Ju mungon legjitimiteti, ju mungon dëshira dhe serioziteti për ta rregulluar.

Bëni këtë gjë, tregoni me akte dhe me shembuj që nuk doni t'i përdorni këto për interesat tuaja, për t'u mbrojtur nga ndjekja penale, dhe më pas diskutojmë. Kjo është një kërkesë që e kam bërë në seancën e kaluar, nuk ka sens të kalojmë në diskutimin në parim. Çfarë do të diskutojmë në parim?! Nuk është ky vendi, nuk jemi ne.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Vasilika, në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, përsëri jemi ne, por në kushte të barabarta. Kjo eliminon çfarëdolloj tentative diabolike për të futur në mënyrë okulte te ndryshimet në Rregullore ato për imunitetin.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Aliebjaj!

Është një debat i ezauruar në mbledhjen e kaluar. Propozimi juaj është hedhur në votë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Miratimi i projektvendimit për ndryshimet në Rregulloren e Kuvendit, sipas asaj që ka përcaktuar Konferenca e Kryetarëve, bazuar në nenin 12, pika 1 të Rregullores së Kuvendit

të Shqipërisë, i kanë kaluar Komisionit të Ligjeve. Ka praktikë parlamentare, madje të ndryshme lidhur me ndryshimet në Rregullore. Herën e kaluar ju dhashë 4 raste të ndryshimit të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, që kanë kaluar në Komisionin e Ligjeve, por sot ka edhe raste kur ndryshimet në Rregullore kanë kaluar edhe nëpërmjet Komisionit të Integritit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Gjithsesi, ky është një debat i mbyllur.

Kush e do fjalën për diskutim?

Urdhëroni!

**Gent Strazimiri** – Zoti kryetar, është hera e dytë që dezinformoni opinionin publik, duke thënë: “Është hera e katërt ose e pestë që Komisioni i Ligjeve miraton Rregulloren e Kuvendit”. Sot, jo rastësisht thotë: “ka kaluar në Komisionin e Ligjeve”.

Ashtu siç ju tha kolegu Alibeaj, Rregullorja nuk përcakton Konferencën e Kryetarëve që të ndajë nëse mund t’ia jap Komisionit të Ligjeve miratimin e Rregullores. Jo, ka një organ të tjetër, që është vetëm për këtë punë, ose kryesisht për këtë punë, është Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, i cili jo rastësisht është në paritet vote dhe kryesisht merret me Rregulloren, me ndryshimet kushtetuese dhe me asgjë tjetër, pikërisht që të detyrohet parlamenti ta bëjë këtë punë në paritet vote. Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, ashtu siç ka ndodhur edhe katër herë të tjera, mbasi ka mbaruar punë me draftin, me votë të barabartë, të dakordësuar, mund t’i thotë Komisionit të Ligjeve, “po, merre formalizojë dhe fute në analet parlamentare derisa ta çosh në seancë”. Po, kjo mund të ndodhë. Por kurrë nuk ka ndodhur që Konferenca e Kryetarëve, në mënyrë krejtësisht të pavarur, sepse kështu e ka vendosur Kryetari i Kuvendit, ia kalon Komisionit të Ligjeve, që, ashtu siç tha Vasilika më parë, “i heqim apo nuk i heqim gjërat atë e përcakton vota”. Këtë ta ndalon Rregullorja e Kuvendit.

Ka ndodhur një herë për një nen që nuk jemi marrë vesh ne, Ulsi, por atëherë ti nuk ke qenë në parlament, dhe maxhoranca e atëhershme, që ishim ne, e ka ndryshuar këtë pikë të Rregullores vetëm me votat e saj.

Të nderuar qytetarë, parlamenti fillonte: pika e parë, çështje jashtë rendit të ditës dhe më pas vazhdonte me rendin e ditës. E vetmja gjë që ka ndodhur, “çështjet jashtë rendit të ditës”, kanë kaluar në fund të seancës. Ky është krimi i madh që është bërë! Edhe sikur të ishte bërë gabim, edhe sikur mos të ishte kjo, përsëri kjo nuk e justifikon faktin se, meqenëse dikush përpara, ta zëmë se do ta kishte shkelur Rregulloren e Kuvendit dhe praktikën parlamentare, hajde ta bëjmë dhe ne sot. Jo, përsëri nuk do të ishte justifikim, por kjo është gjëja që ka ndodhur dhe e kemi bërë dhe e kemi bërë pa konsensusin e opozitës.

“Çështjet jashtë rendit të ditës” nga pika e parë, kanë kaluar te pika e fundit, ashtu si në çdo mbledhje, kur thuhet jemi mbledhur për 1, 2, 3 apo 4 gjëra në fund fare të tjera. Fillonte parlamenti me pikën e parë të rendit të ditës me “e të tjera”.

Ju lutem, doni apo nuk doni ta fusni imunitetin parlamentar, me thënë të drejtën nuk arrij ta kuptoj, mos u sillni si opozitë, sepse jeni maxhorancë. Imuniteti parlamentar është një instrument për të mbrojtur opozitën, jo maxhorancën. Të merret dhe futet në këtë mënyrë banditeske, me këtë mekanizëm, që unë sapo u shpjegova, përmes faktesh dhe provash, imunitetin parlamentar, domethënë, nuk ka qeveri që ju bën më punë.

**Ulsi Manja** – Më fal, është diskutim apo për procedurë?

**Gent Strazimiri** – Të merrni të fusni imunitetin parlamentar, duke qenë në pushet dhe të dalë opozita të thotë: nuk e duam imunitetin parlamentar, siç e kemi bërë dje, kur ishim në pushtet...

**Vasilika Hysi** – Pse gënjeni, ku ka imunitet deputeti?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Gent Strazimiri** – Sigurisht, sot nuk e ka. Por katër faqe, që ka sjellë Taulant Balla, po të ishte imuniteti, nuk do të kishte bërë propozim ai që të fusim imunitetin.

**Vasilika Hysi** – I dini budallenj ju ata që rrinë aty?!

**Ulsi Manja** – Ju lutem, zonja Hysi!

**Gent Strazimiri** – Vasilika, budallenj i di ti njerëzit! Njerëzit nuk janë budallenj. Taulant Balla ka sjellë propozime, pra janë 6 nene, ku tregohet se si procedohet me imunitetin e deputetit.

Së pari, njerëzit mos i bëj për budallenj.

Së dyti, mos u sillni si opozitë, sepse, sido që të vijë puna njerëzit, e di që e kuptoni që jeni minorancë absolute në këtë vend, jeni të vetmuar, nuk ju mbron Rregullorja që e ndërroni mënyrë banditeske, as imuniteti që përpiqeni ta përfshini në këtë mënyrë, janë halle, që nuk i zgjidhni dot në këtë mënyrë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** –Faleminderit, zoti Strazimiri, për diskutimin tuaj!

Kush e do fjalën për diskutim, sepse zoti Strazimiri e kishte procedurë dhe diskutim?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Urdhëroni, zonja Çupi!

**Dhurata Çupi** – Faleminderit!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Këtu propozohen ndryshime në Rregulloren e Kuvendit. Për ndryshimet në Rregulloren e Kuvendit ligjvënësi e ka përcaktuar qartë, ka ngritur një Këshill për Rregulloren e Kuvendit. Tashmë, kur ndryshimet në Rregulloren nuk miratohen në Këshillin e Rregullores, si mund ta sqaroni, vetëm ju qofshi që jeni, që e miratoni në Komisionin e Ligjeve, sepse ligjvënësi e ka përcaktuar qartë, ka ngritur një Këshill për miratimin dhe ndryshimet në Rregullore. Në qoftë se nuk miratohet Rregullorja në atë Këshill, për çfarë është Këshilli?! Në fakt, prapavija juaj e kësaj Rregulloreje nuk është ajo, sepse atje ka edhe diskutime të tjera, kemi dhe votat 5 me 5, edhe ky është qëllimi. Ideja është se ju po përgatiteni për opozitën, dhe kjo është e keqa juaj, po merrni masa, në të gjitha drejtimit, që t'i sistemoni aleatët apo kolegët tuaj, dhe t'i rregulloni edhe me imunitet, edhe me mandatet dhe me efektet financiare. Të gjitha i rregulloni këtu, në Komisionin e Ligjeve, sepse keni edhe numrin më të madh të votave. Më pas me votat vendosni. Tashmë e kemi mësuar: pro, kundër. Ju rrëzoni dekrete, miratoni ligje si të doni, por të paktën Rregulloren respektojeni, vendimmarrjen e ligjvënësit, i cili ka ngritur një Këshill për Rregulloren. Në qoftë se në Rregulloren nuk e miratojmë në Këshill, për çfarë ekziston Këshilli? Nuk e kuptoj?!

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

Kush e do fjalën?

Urdhëroni, zoti Xhafaj!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit, zoti kryetar!

I përmbahem fort bindjes se ndryshimi i Rregullores së Kuvendit është një moment i rëndësishëm në jetën parlamentare të çdo legjislature. Ashtu sikundër mendoj se nuk është një gjë shumë e mirë fakti që ne kemi një ndërhyrje të herëpashershme në Rregulloren e Kuvendit. Nuk është pozitive që nga viti 2005 deri në vitin 2017 Rregullorja e Kuvendit është ndryshuar 8 herë, gjë që nuk flet për një lloj qëndrueshmërie, por ajo që është më e rëndësishmja dhe për një lloj përgjegjshmërie në të gjithë këtë proces. Ashtu sikundër është e drejtë të mendohet se nuk është herezi, por përkundrazi, kur është e nevojshme, është domosdoshmëri ndryshimi i këtij akti, që rregullon funksionimin e brendshëm të parlamentit. E marrë si e tillë, edhe për peshën që ka ky akt, duhet të jetë një proces sa më i kujdesshëm. Në këtë kontekst, dëshiroj ta vlerësoj punën e koleges sime, zonjën Hysi, me materialin që ka paraqitur, është një material shumë skrupuloz, i kujdesshëm dhe që na jep një pasqyrë të qartë së paku të atyre ndryshimeve që janë propozuar deri tani. Jam dakord që duhet të jetë një proces konsensual. Me aq sa e kuptova, edhe kryetari i grupit si të tillë e shikon dhe nuk ka si të jetë ndryshe, përtej disa precedentëve aspak pozitivë për vitet 2008, 2010 dhe 2011 në mos gaboj kur Rregullorja është ndryshuar dy herë pa konsensus.

Propozimet e sjella meritojnë vëmendje dhe besoj se do të meritojnë të gjithë kujdesin e duhur nga ky komision për të bërë të mundur që të kemi një projekt që jetë i qëndrueshëm në kohë. Ajo që më shqetëson është fakti se Rregullorja ekzistuese, por edhe ndryshimet që duam të bëjmë, nuk fokusoheni tek ajo që është shumë e rëndësishme, te roli i deputetëve. Shumë mirë që mendojmë se duhet të sillen mirë deputetët, sepse, për fat të keq, për parlamentin shqiptar, për mjedisin tonë parlamentar është një problem real, i turpshëm do të thosha. Por ajo që duhet të preokupojë këto ndryshime është se si të veprojnë më mirë në interes të procesit të ligjbërës dhe në interes të qytetarit, roli i deputetit në procesin ligjbërës, sepse, në fund të fundit, ne për këtë funksion jemi këtu. Pra, ajo që dua të shikoj më mirë në këto ndryshime është se cilat do të jenë përmirësimet në rolin që luan deputeti në procesin ligjvënës dhe në marrëdhëniet me zgjedhësit.

Ndryshimet e herëpashershme që janë bërë, ashtu siç ju thashë, gati 8 ndryshime, nga vitet 2005 deri në 2017, duhet të jemi të sinqertë që e kanë zbehur rolin e deputetit. Deputetët janë shndërruar sot më shumë në kartonë se sa në persona me integritet për fjalën, për përfaqësimin e zgjedhësve të tyre dhe për ndikimin që kanë në procesin ligjvënës të parlamentit. Kjo gjë duhet të na shqetësojë më shumë. Të gjitha ndryshimet që janë bërë, e kanë zbehur së tepërmi këtë rol. Është momenti për të parë se si mund t'i zhbëjmë disa nga ato ndryshime, të cilat koha i vërtetoi se ishin të padobishme, të dëmshme dhe e shndërruan legjislativin në një zgjatim të ekzekutivit. Në këtë kontekst ka disa probleme që lidhen, ndoshta, do të sugjeroja unë edhe me vetëfunksionimin e komisioneve parlamentare. Disa dispozita për mënyrën se si funksionojnë komisionet parlamentare janë të paqarta lidhur me kuorumin, me vendimmarrjen, me leximin në parim të projektligjit, nen për nen dhe në tërësi. Nuk ka arsye pse të nxitojmë. Nëse do të ketë disa lexime, që do të jenë në vëmendje të deputetit, por edhe në transparencë të plotë parlamentare, do të evitohem kontestet e ndryshme, konfliktet apo edhe gabimet që ndodhin shpeshherë në gjithë këtë proces. Gjithashtu, duhet parë me vëmendje edhe çështja e ekipeve, e stafëve që kanë komisionet dhe stafit që kanë deputetët, nëse duam cilësi në procesin ligjvënës.

Ne jemi ndeshur edhe me një aspekt tjetër shumë të rëndësishëm në këtë Kuvend, me funksionin monitorues, kontrollues të Kuvendit dhe të komisioneve të përhershme parlamentare, duke përfshirë këtu edhe komisionet e posaçme që krijohen. Dispozitat që kemi janë shumë të paqarta, madje shpeshherë janë edhe burim për konflikte ndërmjet grupeve politike, përtej lojës së rëndomtë dhe lojës politike për interesat e politikës së ditës, por edhe për shkak të këtij handikapi që ka vetë mënyra se si e kemi formësuar këtë proces. Duhet të jemi të ndërgjegjshëm që funksioni monitorues dhe kontrollues i legjislativit mbi ekzekutivin



dhe institucionet e tjera, që burojnë prej tij, sot është i dobët edhe për këtë shkak. Ndoshta është momenti për ta riparë. Ndoshta koha e kufizuar dhe *deadline*-i, që ka projekti në raport me disa detyrime ndërkombëtare nuk e mundëson, por ky është një aspekt tjetër që duhet parë me vëmendje nga kryesia e komisionit.

Për sa i përket çështjes se ku do të shqyrtohet ky projekt, mendoj se kjo nuk është thelbësore. E para, sepse e rëndësishme është përmbajtja e tij, sa ky projekt është në përputhje me Kushtetutën dhe me qëllimin që kemi. E dyta, sepse vetë Rregullorja e Kuvendit në nenin 117 është shumë e qartë: “Ndryshimet në Rregulloren e Kuvendit kalojnë në të njëjtën procedurë, si çdo procedurë tjetër në aspektin ligjbërës”.

Me të drejtë mund të shtrohet pyetja: po Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin ku është? Kjo është një pyetje e ligjshme. Në Këshill ndoshta mund të kalojë versioni final që ai të shprehet, pasi komisioni të ketë bërë një punë paraprake të të gjithë këtij procesi, i cili ka të bëjë me aspekte të teknikës legislative, që ka të bëjë me aspekte të përmbajtjes së projektit, pastaj Këshilli mund t’i marrë në shqyrtim në parim. Po të shohësh me kujdes edhe dispozitën përkatëse për Këshillin, është pak ambigüe dhe përdoret fjala “studion”. Nëse do t’i analizojmë të dyja këto dispozita bashkë, nga kjo pikëpamje ne mund ta tejkalojmë këtë procedurë, në mënyrë që të bëjmë një proces të plotë në Komisionin e Ligjeve. Në finale Këshilli i Mandateve mund të shprehet përpara se ta kalojmë në seancë, për sa kohë që nuk duhet thjesht vullneti i palëve, por domosdoshmëria, fryma e këtij akti është që të jetë një dokument që do të ketë votë konsensuale në parlament.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Xhafaj!

Kush e do fjalën?

Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, e ndoqa me vëmendje diskutimin e kolegut Xhafaj dhe pajtohem me shqetësimet, por edhe me tërheqjen e vëmendjes në disa pika ku ne duhet të jemi të kujdesshëm.

Të nderuar kolegë, ky dokument është shumë i rëndësishëm dhe, siç e dini, kjo Rregullore është miratuar në vitin 2004, ndërkohë që nga viti 2004 dhe në vijimësi janë miratuar një sërë ligjesh dhe ka disa ndryshime kushtetuese, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në veprimtarinë e parlamentit.

Po të shikoni tabelën që keni para, dokumenti përmbledh një sërë propozimesh, të cilat nuk janë ndryshime të vogla, por sjellin një ndryshim, një përmirësim të mënyrës së funksionimit të Kuvendit të Shqipërisë në katër drejtime.

E para, në aspektin legjislativ. Zoti Xhafaj tha me të drejtë se ka nevojë që të rregullohet veprimtaria e komisioneve, transparenca, raportet e punës në komision, komision përgjegjës, komision për dhënie mendimi me seancën; një pjesë e mirë e tyre janë adresuar. Megjithatë, në cilësinë e relatores unë mirëpres çdo koment dhe amendament në dispozitat që mendohet se kanë nevojë për përmirësim.

E dyta, ky projekt reflekton rekomandimet e projektit IPA. Ky është projekt i BE-së. Në progresraportin e BE-së, në të dyja raportet e fundit, i është lënë detyrë Kuvendit të Shqipërisë të miratojë ndryshimet në Rregullore. Kjo Rregullore është miratuar në vitin 2004, kur ne si parlament nuk kemi qenë aktivë në proceset e integritit evropian. Sot parlamenti ka një funksion shumë të rëndësishëm jo vetëm për shkak të një ligji të posaçëm që është “Roli i Kuvendit në proceset e integritit evropian”, por ne kemi një proces shumë të rëndësishëm për përafrimin e legjislacionit dhe për kontrollin parlamentar, pasi një ligj është miratuar. Më lejoni t’ju them se nga 30 rekomandime që ka paraqitur IPA, dhe janë rekomandime që ne i kemi marrë në konsideratë, duke i analizuar një nga një, 23 janë reflektuar dhe shumica e tyre ka të bëjë me forcimin e rolit monitorues të Kuvendit. Besoj se është në dinjitetin e këtij Kuvendi dhe tonin si deputetë që të sanksionojmë në Rregullore se ligjet, që kanë të bëjnë me përafrimin e legjislacionit, të marrin të gjithë kohën e nevojshme dhe nuk mund të kalojnë me procedurë të përshpejtuar. Pikërisht adresohet shqetësimi, të cilin e ngriti me të drejtë kolegu Xhafaj, që këtyre ligjeve duhet t’u japim kohën e mjaftueshme, që nuk do të pranohen më ligje që do të vijjnë nga qeveria pas pasur tabelën e përafrimit dhe vlerësimin e impaktit, por risia tjetër është që Kuvendi, edhe pasi ta miratojë një ligj, pas tre vjetësh duhet të rishikojë nëse ky ligj u qëndron standardeve dhe është në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian.

Gjithashtu, të nderuar kolegë, në vitin 2004, kur është miratuar Rregullorja, GRECO, pra grupi shteteve antikorruption, nuk ka pasur rekomandime konkrete për Kuvendin e Shqipërisë. Raporti i dytë për raundin e katërt të GRECO i ka kërkuar Kuvendit të Shqipërisë të përmbushë një sërë detyrimesh. Kjo nuk bëhet pse e kërkon GRECO, por kjo është e domosdoshme, sepse e kërkojnë qytetarët. Besoj se të gjithë ata, që na kanë votuar dhe që na kanë besuar për t’i përfaqësuar, duan të dinë se si deputetët dhe Kuvendi i shpenzon paratë e buxhetit, pra transparenca financiare e burimeve të financimit të Kuvendit dhe e përdorimit të tyre nga deputetët e Kuvendit të Shqipërisë gjen një rregullim të veçantë në ndryshimin që i bëhet Rregullores. Ne nuk mund të themi që nuk jem dakord për të forcuar transparencën.

E dyta, qytetarët, zgjedhësit, shoqëria civile kanë nevojë të dinë kalendarin e veprimtarisë së Kuvendit. Ne shpesh diskutojmë nëse botohen procesverbalet në kohë, a është botuar projektligji dhe cilat janë grupet që kanë lobuar në parlament apo kush i ka sjellë

amendamente. Këto gjëra nuk janë të rregulluara në Rregullore, të nderuar kolegë. Pikërisht kjo çështje duhet rregulluar. Ky është grupi i dytë i dispozitave.

Grupi i tretë i dispozitave ka të bëjë me etikën parlamentare. Kemi miratuar Kodin e Sjelljes. Me të drejtë kolegu Xhafaj tha se ka rëndësi, por nuk është vetëm kjo. Besoj se seanca e fundi ka qenë një model shumë i shëmtuar i komunikimit dhe, në këtë kuadër, ky Kod Sjellje nuk do të kishte vlerë nëse nuk do të ketë edhe mekanizimin forcues, masat disiplinore dhe procesin ku duhet të kalojë zbatimi i këtyre masave disiplinore. Edhe kjo është një kërkesë e GRECO-s, por MONEYVAL-i, mekanizmi tjetër i Këshillit të Europës për pastrimin e parave, i ka kërkuar Kuvendit të Shqipërisë në muajin dhjetor, kur se bashku me Kryeministrin paraqitem planin e veprimit, forcimin e rolit të kontrollit parlamentar të Kuvendit. Me thoni një nen të Rregullores ku gjejnë rregullim të gjitha planet e veprimit që ka miratuar Kuvendi, qoftë për integrimin europian, qoftë për Këshillin e Integritetit Europian; më thoni një nen të Rregullores që reflekton ligjin për rolin e Kuvendit në proceset e integritetit europian, i cili, megjithëse është miratuar në vitin 2015, ka ende një vakuum. Më thoni një nen të Rregullores që i detyron komisionet që rezolutat që ne kemi miratuar, t'i nënshtrohen kontrollit. Besoj se në këtë kuadër, shumë i rëndësishëm, të cilën e tha me të drejtë kolegu Xhafaj, është kontrolli parlamentar. Dispozitat që bëjnë fjalë për kontrollin parlamentar amendohen pothuajse të gjitha. Ky është një propozim i ekspertëve të Bashkimit Europian, i projektit IPA. Është një propozim i të gjithë deputetëve, i stafit të Kuvendit. Në fund të fundit, ne duhet ta sjellim Rregulloren në funksion të kontrollit parlamentar, sepse kemi ngritur një mekanizëm me votat e të gjithë deputetëve.

E fundit, meqenëse flasim shumë për imunitetin, do të doja, të nderuar kolegë, të bëj të qartë që të mos i keqinformojmë qytetarët se që nga viti 2012 deputetët e Kuvendit të Shqipërisë nuk kanë imunitet, me përjashtim të rastit të arrestimit dhe të kontrollit të banesës. Pra, nuk kanë imunitet nga ndjekja penale. Në këtë kuadër, ju sot po flisni për një përafrim të Kushtetutës, të miratuar me 140 vota, me Rregulloren e Kuvendit. Rregullorja duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën dhe Rregullorja duhet të përafrohet me Kushtetutën. Ju sot thoni: mos e bëni këtë!

*(Reagime pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Ju lutem, ta mbyllë mendimin, zonja Hysi!

**Vasilika Hysi** – Ne mund të bëjmë politikë, mund të flasim dhe t'i tërheqim zgjedhësit tanë që të na ndjekin në takime e në protesta, por jo me një dokument, që është ligji themeltar i Kuvendit të Shqipërisë dhe, ju, të nderuar kolege, pasi të mbaroni protestën e 16 shkurtit, këtë Rregullore do ta zbatoni qofshi në opozitë, apo kur të vini në maxhorancë, por nuk e di pas disa

vitesh do t'ju vija radha të jeni në maxhorancë me këtë mënyrë sjelljeje. Prandaj do t'ju lutem që të ulemi e t'i marrin një për një nenet dhe përsëri ju ftoj që, nëse ka mendim e sugjerime, sepse, me sa kuptova, kolegu Xhafaj dhe kolegja Bushka kanë komente e sugjerime, kurse kolegu Fino i ka depozituar në kohë të gjitha komentet e sugjerimet, të cilat i kam parë që janë shumë të drejta, hajdeni të ulemi e të bëjmë një Rregullore, e cila i takon vitit 2019, në prag të hapjes së negociatave, dhe ka një sërë detyrimesh të reja, që nuk i ka pasur as në vitin 2004, as në vitin 2008 dhe as në vitin 2013.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Ju faleminderit, zonja Hysi!

Zoti Naço, a e keni kërkuar fjalën për diskutim?

**Nasip Naço** – Po.

**Ulsi Manja** – Mund të vazhdoni.

**Nasip Naço** – Faleminderit, zoti kryetar!

Sigurisht, në emrin tim, por edhe në emër të Grupit Parlamentar të LSI-së kemi qenë plotësisht dakord për t'u ndryshuar kjo Rregullore, për të përafuar këtë Rregullore me Kushtetutën dhe jo Kushtetutën me Rregulloren. Sigurisht, zoti kryetar, keni zgjedhur mënyrën e gabuar, pasi në këmbën e majtë keni veshur këpucën e djathtë dhe anasjelltas. Po të lexosh nenin 13 të Rregullores, aty flitet qartë se si bëhet ndryshimi i Rregullores. Këtu thuhet që kështu është bërë edhe herë të tjera. Personalisht, nuk kam marrë pjesë në shkëljen e Rregullores herët e tjera dhe nuk dua të marr pjesë. Pra, në qoftë se kam gabuar disa muaj më parë apo disa vjet më parë, nuk dua të gaboj as sot. Dikush që e merr përsipër të thotë se Rregullorja flet ndryshe dhe do ta zbatojë ndryshe, është çështje e tij. Pra, e thashë që në fillim, të veshësh këpucën e majtë në këmbën, këtë keni bërë ju sot, pra vini e diskutoni për të ndryshuar. Në parim jemi të gjithë dakord që të ndryshohet Rregullorja, të përmirësohet kjo Rregullore.

Për sa i përket imunitetit të deputetëve, sigurisht që Kushtetuta e përcakton qartë në nenin 73 se çfarë imuniteti ka deputeti. Për mendimin tim personal, por edhe të forcës që përfaqësoj, kemi qenë dakord që deputeti të mos ketë asnjë lloj imuniteti dhe deputeti sot ka imunitet. Kushtetuta e përcakton se çfarë lloj imuniteti ka. Në neni 73 thuhet se deputeti nuk mund të arrestohet ose t'i hiqet liria në çfarëdolloj forme ose ndaj tij të ushtrohet kontroll personal ose i banesës pa autorizimin e Kuvendit. Nenet 288 dhe 289 të Kodit të Procedurës Penale flasin qartë dhe është bërë ndryshimi përkatës në përputhje me Kushtetutën. Ajo që ne shikojmë në këtë ndryshim të Rregullores, që e keni aplikuar edhe disa muaj më parë, ka të bëjë me mënyrën se si e mendoni ju Rregulloren kur ka raste të heqjes së imunitetit për dhënien

e autorizimit për arrestimin e deputetëve. Duke qenë se keni numrat në Kuvend, kërkoni që në çdo rast ta ktheni në gjykatë dhe në prokurori këtë këshill. Ne kërkojmë që të zbatohen Kushtetuta, Kodi i Procedurës Penale, pa pasur ju të drejtën...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë kam qenë ministër i Drejtësisë, zonja Vasilika, jua kam propozuar dhe ju e keni votuar.

**Vasilika Hysi** – Nisma “Balla” është fjalë për fjalë Kodi i Procedurës Penale.

**Nasip Naço** – Se çfarë thotë zoti Balla këtu dhe se çfarë sjellë me shkrim zoti Balla është tjetër gjë, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Kodi i Procedurës Penale është.

**Nasip Naço** – Nuk është e njëjta gjë, se e kemi këtu, zonja Hysi. Ju kërkoni që Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin ta keni të barabartë, 5 me 5, siç është, por kuorumi të jetë 5 me 5. Zonja Hysi, e keni të shkruar, pra keni kërkuar që mund të vazhdojë edhe me 5. Nesër mund të kërkoni që edhe komisioni të jetë i barabartë, pra edhe me gjysmën mund të vazhdojë, por edhe parlamenti nga 140...

*(Reagim pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Zonja Hysi, ta mbyllë diskutimin zoti Naço.

**Nasip Naço** – Unë përfaqësoj veten time. Jam shumë korrekt në atë që them, zonja Hysi.

Kështu që për të mos zgjatur, zoti kryetar, nëse ju do të vishni këpucën e majtë në këmbën e majtë dhe do ta ktheni këtë proces te Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, jemi gati të japim të gjithë kontributin e nevojshëm për ta përmirësuar, për ta votuar dhe për të dhënë konsensusin e mundshëm.

Faleminderit, zoti kryetar!

**Ulsi Manja** – Shumë faleminderit, zoti Naço! Në fakt, unë si i majtë që jam nuk di t’i ndërroj këpucët njëherë majtas dhe njëherë djathtas, unë këpucët i vesh sikurse vishem. Mos më ngatërroni me ndonjë parti apo me ndonjë deputet të ndonjë partie tjetër, sepse unë këpucën e majtë e vesh te këmba e majtë, të djathtën tek e djathta.

Kush e do fjalën për diskutim?

Zoti Bylykbashi.

**Oerd Bylykbashi** – Zoti kryetar, është ngritur një çështje secilës më parë duhet patjetër t’i jepet një zgjidhje proceduralisht. Ne kemi një propozim për ndryshimin e Rregullores. Detyra juaj, së pari, si kreu i këtij komisioni, më pas e komisionit, është t’i bindeni Rregullores, të lexoni qartë se çfarë thotë neni 13 i Rregullores. Neni 13 i jep tagrin Këshillit

për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin për të studiuar propozimet e bëra për ndryshimin e Rregullores. E ka bërë zonja Hysi, kushdo tjetër, me propozim nga populli, bën vaki edhe Kryeministri të na sjellë një ndryshim në Rregullore. Kjo çështje i takon Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin për një gjë shumë të thjeshtë: ndër të tjera është pariteti që ka ky Këshill. Ju e mbani mend shumë mirë dhe e dini shumë mirë që Rregullorja miratohet me 50% +1 të votave, pra me shumicën absolute të Kuvendit. Ju e mbani mend shumë mirë zhurmën tuaj për miratimin e atyre ligjeve të famshme në vitin 2012-2013, pra bllokimin që i bëtë procesit të integritimit për ligje, që kishit rënë dakord edhe për presjen e fundit, i bllokoni. Ndër to bllokuat edhe Rregulloren e Kuvendit, për të cilën kishit rënë dakord, edhe pse ishte me shumicë absolute votash, të cilën maxhoranca e PD-së e zotëronte, gjithsesi në pritëm momentin kur ju ratë dakord të vinit për të votuar me konsensus, për shkak se nuk është thjesht ligji themeltar i Kuvendit, sepse në ligj themeltar kemi Kushtetutën, por kjo është ajo që na rregullon ne dhe, sa më shumë t'i kemi rregullat e përbashkëta, aq më mirë është. Pra, jo më kot Rregullorja sot e kësaj dite e ka Këshillin me paritet për ta arritur maksimalisht konsensusin. Por e thotë edhe shumë qartë: propozimet studiohen nga ky këshill. Nëse ky komision merr sot vendim, e çon në seancë. Pra, ju i hiqni mundësinë organit, që përcakton Rregullorja, të bëjë një debat mbi bazë pariteti, jo mbi bazë maxhorance. Ta kërkojmë atje konsensusin për normat që rregullojnë punën e Kuvendit. Kështu që, nëse ju, si maxhorancë, shmangeni nga rrjedha juaj e vazhdueshme dhe e qëndrueshme për të shkelur Rregulloren, për ta ngushtuar në çdo moment hapësirën që ka opozita në komisione, por, mbi të gjitha, duke dhënë modelin se si shkelet çdo akt që rregullon funksionimin e këtij shteti, sot keni mundësinë ta pranoni kërkesën tonë. Ky dokument duhet të shqyrtohet nga Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, përndryshe jeni duke shkelur Rregulloren. Vetëm atje ne mund të bëjmë debatin dhe të nxjerrin konkluzionet e duhura për këtë Rregullore. Kushtetuta nuk është vetëm ajo që shkruhet, por edhe ajo që ne zbatojmë. Në qoftë se deri sot ne jemi përpjekur që për çdo rast të gjejmë konsensusin për një dokument të këtij lloji, ju e thyeni këtë dritë dhe, sigurisht, kjo nuk jep asnjë lloj modeli funksional për këtë Kuvend. Para se të vazhdojmë me diskutime të gjata në detaje dhe zonja Hysi të thotë: “Propozimin tuaj e dëgjova dhe e mbajta shënim. Jam dakord, nuk jam dakord”, unë mendoj që kjo është kompetencë e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin dhe jo e këtij komisioni.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** –Faleminderit!

Zoti Fino, për procedurë.

**Bashkim Fino** – Dëgjova kolegët e opozitës, ku propozimi i tyre në thelb është që ne të diskutojmë këtë projektregullore në Këshillin për Rregulloren Mandatet dhe Imunitetin dhe jo këtu, e ka nenin 13. Unë e thashë edhe herën e kaluar që kjo është Rregullorja jonë, e të gjithë deputetëve dhe nuk është e njëanshme. Asnjëherë Rregullorja nuk është bërë e njëanshme, edhe kur kanë qenë këta në pushtet dhe ne në opozitë, sepse rregullon marrëdhënien tonë si deputetë në mirëfunksionimin që kemi ne gjatë gjithë kohës. Të bësh debat pa bazë dhe pa logjikë për Rregulloren, për mua është absurde. Mund të gjeni një kauzë tjetër për të bërë debat dhe për të ngritur çështje politike, është e drejta juaj, por të bësh debat për Rregulloren sesi do të vijojmë dhe si do të flasim, mua më duket pa bazë.

Po ua them edhe kolegëve të mi. Kush janë anëtarët e Këshillit për Rregulloren dhe Mandatet?! Ne jemi. Kush është 10-shja e Këshillit të Rregullores?! Jemi prapë ne, pjesa dërrmuese 90%, përjashto Gramoz Ruçin, që është Kryetar Kuvendi, jemi ne anëtarët e Komisionit të Ligjeve. Ne nuk mund të jemi ndryshe këtu e ndryshe atje dhe të themi: “Nuk dua ta kaloj këtu, sepse është Komisioni i Ligjeve” dhe atje të thoni: “Jam në rregull me këtë draft dhe mund të bëjmë disa ndryshime”. Domethënë, ne jemi edhe këtu, edhe atje dhe nuk mund të jemi ndryshe këtu dhe ndryshe atje. Pse e sollëm këtu?! Sepse ju, kolegë të opozitës, për një kohë të gjatë nuk erdhët në Këshillin për Rregulloren dhe Mandatet dhe ne nuk donim ta merrnim vendimin me 5 vota, por bashkërisht, pasi kjo është Rregullorja jonë dhe thamë ta diskutojmë më gjerësisht në Komisionin e Ligjeve. Nëse ju doni që këtë draft ta kalojmë atje, e kalojmë, por prapë ti do të jesh atje, Naço do të jetë atje, unë do të jem atje. Logjika ime është që ne të mos gjejmë artifica kot për të bërë debat. Në qoftë se duam të fillojmë diskutimin nën për ne për të rregulluar Rregulloren tonë, jo timen, hajde ta fillojmë, sepse në këtë draft janë mendimet dhe sugjerimet e të gjitha palëve, nuk janë vetëm të zonjës Hysi, janë të miat dhe të zotërinjve të opozitës. Prandaj, hajdeni ta shikojmë dhe ta rregullojmë, sepse kjo është Rregullorja jonë. Unë nuk shikoj asgjë të keqe që të na ndajë dhe të zihemi duke thënë: “Të mos e bëjmë këtu që jemi 20 veta, por atje që jemi 10”. Prandaj, shikojeni me dashamirësi për ta trajtuar dhe kaluar. Kërkesa ime është shumë dashamirëse.

**Ulsi Manja** – Fjalën e ka zoti Alibeaj.

**Enkelejd Alibeaj**- E pashë me syrin për të gjetur dashamirësinë, por me këtë sy duhet ta gjeja edhe te letrat, zoti Fino. Po të them vetëm dy gjëra të thjeshta për të kuptuar ti dhe kushdo nga publiku, i cili, ashtu si edhe ne, është në terr për ato çfarë përmbajnë letrat e Vasilikës. Çfarë thotë Vasilika?! Gjëja e parë, ajo njeh edhe nenin 13 të Rregullores, atë që sapo ju e ngritët në pedestal, sepse ashtu është, kur diskutohen dhe studiohen ndryshimet e Rregullores, Vasilika këtë ka bërë, i ka studiuar vetëm pa asnjë person tjetër, duhet të

diskutohen në Këshillin e Mandateve. Vasilika ka studiuar dhe ka shkruar: “Ta ndryshojmë nenin 13 të Rregullores dhe t’ia heqim këtë të drejtë atij Këshilli për të diskutuar ndryshimet e Rregullores”. Që këtu vjen erë. Jo vetëm kaq, por në fund të këtij materiali, të sjellë në befasi prej Vasilikës, qëndrojnë ende dy dispozita, nga më të gjatat, që bëjnë fjalë për çështje të imunitetit. Këtë kemi frikë ne, jo se ju nuk e dini Rregulloren, por po të doni ju të shtireni para publikut si të përgjëruar për konsensus, për të rregulluar statusin e deputetit, IPA GRECO, gjëra që nuk kanë fare rëndësi. Këtu bie dakord me ty, sepse janë çështje të teknikës më elementare dhe burokratike, që duhet të rregullohen dhe s’kanë nevojë fare të diskutohen me kaq tam-tame të mëdha. Çështjet e rëndësishme të Rregullores, që kanë edhe tingull politik, janë ato të mënyrës sesi funksionon ky parlament dhe gjëja është politike. Publiku e di fare mirë sesi funksionon ky parlament dhe se çfarë ndodh me të drejtat elementare të një deputeti, sigurisht kur ai është i opozitës ose i grupeve parlamentare. Kjo është çështje politike dhe parlamenti nuk ekziston. Çështja më e madhe e politikës me interes publik është ajo e imunitetit. Këto i ka shkruar Vasilika në amendamentet e veta, i ka studiuar vetëm dhe thotë: “Po të doni, m’i sillni mua objeksionet”, pastaj, nëse i pranon Vasilika, janë në rregull, por, nëse nuk i pranon, vazhdoni ju me votë. Jo, Këshilli i Mandateve ka një gjë në thelb: testimin e sinqeritetit të maxhorancës që nuk do ta përdorë për interesat e veta. A e patë përgjërimitin e Taulant Ballës kur tha: “Me konsensus nuk ndryshojmë asgjë, do të respektojmë traditën”, urdhëro pra! Këshilli i Mandateve dhe i Rregullores është ai që përcakton në mënyrë të qartë konsensusin. Konsensus me kobure në tavolinë, kjo vetëm se keni shumicën?! Kujt ia hidhni këtë? Aq më tepër që nuk e keni për herë të parë përdorimin e këtij lloj mekanizmi. Prandaj për këtë arsye bie dakord me atë që thotë zoti Fino: “Kalojani Këshillit të Mandateve dhe të Rregullores”. Ne duhet ta studiojmë së bashku. Propozimi ynë është të respektojmë Rregulloren dhe ato çfarë kolegët thanë.

**Vasilka Hysi**– Ka shtrembëruar...

**Ulsi Manja**- Nuk ka asnjë shtrembërim, sepse ai për të shtrembëruar ka ardhur, por problemi është se ...

**Enkelejd Alibeaj** –Ulsi , kam edhe një gjë, diskutime me natyrë personale nuk ka...

**Ulsi Manja** – Unë nuk jam Ulsiu...

**Enkelejd Alibeaj**- Kushdo qofsh!

**Ulsi Manja** – Respekto etikën e komisionit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Vasilika Hysi** – Rregullorja e Kuvendit zbatohet njësoj si në seancë plenare, ashtu edhe në komision. Prandaj, përderisa kolegu nga fillimi i fjalës deri në fund, dhe kolegët e tjerë,



që, me sa kuptoj, nuk e kanë lexuar Rregulloren dhe nuk shohin përbri se kush i ka bërë propozimet, po u them se nga 65 nene, ku përfshihet edhe dispozita kalimtare, 23 propozime janë të projektit IPA, 12 amendamente janë të kolegut Alibeaj, pjesa tjetër është e stafit të Kuvendit, unë nuk kam asnjë.

Faleminderit!

**Ulsi Manja**- A ka diskutime të tjera?

**Nasip Naço** – Kam një saktësim. Unë pak më parë gabova, zoti kryetar, dhe kërkoj falje, sepse, sipas zonjës Hysi, kam gabuar unë, por unë kam një material këtu përpara dhe te neni 13, për pikën e fundit, këtu në krah është shkruar që propozimin e ka bërë zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Ato janë komente që bëj unë.

**Nasip Naço** – Këtu thuhet: “Propozuesi”, kjo është ajo çfarë kërkon Vasilika, as më shumë dhe as më pak, por, edhe nëse janë 5 deputetë, të vazhdojnë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kështu e kam kuptuar unë, zonja Hysi, dhe, nëse kam gabuar, ju kërkoj ndjesë!

Nëse unë shoh që ju keni gabuar, nuk mund të vazhdoj më tej.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Oerd Bylykbashi** –Me logjikën që keni, Këshilli i Rregullores dhe Mandateve do të studiojë vendimin e Komisionit të Ligjeve për këto propozime?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Është shumë e thjeshtë, Konferenca e Kryetarëve ka marrë një vendim të gabuar, ia ka sjellë Komisionit të Ligjeve, i cili e konstaton që nuk është ky organi që studion propozimet dhe ia kthen mbrapsht Konferencës së Kryetarëve, ajo ia jep...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kjo është logjike. Ne duhet të anulojmë nenin 13 në këtë moment deri sa të kalojë propozimi, i cili vjen këtu nga ana jua, që t’ia heqim Këshillit të Rregullores dhe Mandateve kompetencën për të studiuar propozimet, deri sa të bëhet ajo. Nëse ne vazhdojmë në këtë formë, praktikisht anulojmë nenin 13, kompetencat që i jepen atij Këshilli, sepse, po mori ky komision vendim, e nxjerr Këshillin nga loja.

**Ulsi Manja** – Shumë faleminderit!

Para se të hedh në votim propozimin e kolegëve të opozitës, dhe në parim projektvendimin për ndryshimet e Rregullores, dua të them edhe unë dy fjalë.

Së pari, Rregullorja e Kuvendit, saktësisht neni 13, ka paqartësi në lidhje me ndryshimet e Rregullores. Duke qenë se parlamenti ka pasur disa praktika parlamentare të ndryshme të ndjekura për shqyrtimin e ndryshimeve në Rregulloren e Kuvendit, një herë në

Komisionin e Ligjeve, një herë në Këshillin e Rregullores dhe Mandatet dhe një herë në Komisionin e Integritimit, ndoshta është rasti që pjesë e këtyre ndryshimeve në Rregullore të bëhet edhe vetë neni 13, në mënyrë që të qartësohet procedura që do të ndiqet në rastin e ndryshimeve të Rregullores.

Neni 12, pika 1, i Rregullores përcakton qartë kompetencat që ka Konferenca e Kryetarëve si organ e Kuvendit. Unë e thashë edhe në mbledhjen e parë se Konferenca e Kryetarëve ka vendosur që për shkak të bojkotit të opozitës dhe të bllokimit të punës në Këshillin e Mandateve dhe të Rregullores, ku jemi në barazi numrash, 5 me 5, ka vendosur me vendim t'ia kalojë ndryshimet e Rregullores së Kuvendit, Komisionit të Ligjeve dhe këtë e ka bërë në përputhje me nenin 12, pika 1, të Rregullores ku thuhet: “Konferenca e Kryetarëve diskuton dhe vendos për programin e punës, kalendarin e punimeve të Kuvendit dhe të komisioneve të tij, si dhe për çështje të zhvillimit të punimeve të Kuvendit në seancë plenare”.

Kalojmë te neni 13 i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, i cili ka 6 pika, por ju lexoni vetëm pikën 2, ku thuhet: “Studion propozimet për ndryshimin e Rregullores”, por sesi i studion propozimet për ndryshimin e Rregullores nuk e thotë neni 13, por neni 117 i Rregullores: “Ndryshimet në Rregullore ndjekin të njëjtën procedurë që ka përcaktuar Rregullorja si për shqyrtimin e projektligjeve të zakonshme”. Rregullorja duhet lexuar e gjitha, jo vetëm neni 13/2. Neni 13, pika 6, e thotë qartë: “Këshilli mbledhet në mënyrën e parashikuar nga kjo Rregullore për komisionet e përhershme”. Duke lexuar nenin 13/6 në raport me nenin 17, ku ndryshimet në Rregullore ndjekin të njëjtën procedurë miratimi si projektligjet e zakonshme, kjo nuk e përjashton Komisionin e Ligjeve të jetë pjesë e diskutimit dhe ndryshimit në Rregullore e Kuvendit.

Ka një diskutim për atë që thonë kolegët e opozitës: “Merr vendim Komisioni i Ligjeve, ta kalojnë përsëri në Këshillin e Mandateve, sepse ne nuk kemi besim te ju”, por, të nderuar kolegë, këta kërkojnë besim dhe reciprocitet, kur në seancën tjetër, kryetari i grupit parlamentar, por edhe ne ju kemi thënë qartësisht: “Është Rregullorja jonë, jo e të tjerëve, dhe pa konsensusin tuaj nuk kalojnë ndryshimet në Rregullore e Kuvendit të Shqipërisë”. Nëse kërkon reciprocitet, duhet të kishit ardhur në Kuvend, të mos e kishit bllokuar Këshillin e Mandateve dhe të Rregullores, por t'i kishim shqyrtuar këto ndryshime me kohë. Unë pajtohem edhe me mendimin e kolegëve, që u hodhën këtu, t'i kalojmë ndryshimet në Rregullore në Komisionin e Ligjeve, ku relatore është zonja Hysi, por le të jenë edhe 3 bashkërelatorë, një nga opozita, një nga PD-ja dhe një nga LSI-ja, dhe grupi i punës, pasi t'i miratojë ndryshimet në parim, le të punojë dhe t'i sjellë të gjitha ndryshimet që kërkohen në Rregullore në variantin final, t'i miratojmë në Komisionin e Ligjeve dhe Konferenca e Kryetarëve në përputhje me

nenin 12/1 të Rregullores le ta vendosë. Unë nuk e kuptoj se ku është diskutimi këtu. Konferenca e Kryetarëve, pasi ne t'i sjellim në variantin e dakordësuar final të gjitha ndryshimet e propozuara në Rregulloren e Kuvendit, të marrë vendim dhe t'ia kalojë për studim Këshillit të Mandateve dhe Rregullores.

Kështu që hedhim në votim propozimin e opozitës.

Ju lutem, kolegë të maxhorancës, sipas Rregullores, duke qenë se ka një propozim nga kolegët e opozitës që projektvendimi për ndryshimet në Rregullore t'ia kalojë Këshillit të Mandateve, e hedhim në votim dhe, nëse rrëzohet, atëherë nuk i votojmë në parim ndryshimet në Rregullore në Komisionin e Ligjeve.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kush është pro propozimit të opozitës që ndryshimet në Rregullore të kalojnë në Këshillin e Mandateve dhe Rregullores? 5 pro, 10 kundër.

Nuk miratohet.

Kush është dakord në parim me projektvendimin “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet në parim projektvendimi për ndryshimet në Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë.

Relatorja, kolegët e Komisionit të Ligjeve, por edhe çdo deputet i Kuvendit të Shqipërisë është i lutur që gjatë kësaj kohe të japë kontributin e tij për të gjitha ndryshimet që propozohen në Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë dhe më pas t'ia kalojmë dhe t'ia miratojmë nen për nen. Nëse Konferenca e Kryetarëve pas miratimit të draftit final dhe raportit në Komisionin e Ligjeve vendos t'ia kalojë në Këshillin e Mandateve dhe të Rregullores, kjo është një vendimmarrje e Konferencës së Kryetarëve në përputhje me nenin 12/1 të Rregullores.

Këtu e mbyllim mbledhjen e komisionit të ligjeve për ditën e sotme.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

**MBYLLET MBLEDHJA**

